



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 8 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2015, për transparencë në Komuna, nenit 32 pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më, 22.03.2018 miratoi këtë

#### V E N D I M

#### PËR KONSULTA PARAPRAKE PUBLIKE LIDHUR ME RREGULLOREN PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NË KOMUNËN E PRISHTINËS

##### I.

Miratohet Vendimi për dërgimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Prishtinës, në konsulta paraprake publike.

##### II.

Komisioni lidhur me vendimin e cekur në pikën I, do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin - qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatave informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t'i diskutuar propozimet.

##### III.

Konsultat paraprake publike për rregulloren e cekur në pikën I të këtij vendimi, do të jenë në afat për 15 ditë.

##### IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.

##### V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-422/01-70147/18, më 23.03.2018



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta